



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV**

Nr. 814/9 prot.

Tiranë më 3.7.2018

**VENDIM**

Nr. 27, datë 3.7.2018

**MBI**

**ZBATIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 31/1, a/1 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “HTT - High Tech Tests” sh.p.k. Tiranë,

**KONSTATOVA SE:**

Në zbatim të Urdhrit Nr.147, datë 18.05.2018, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në datë 23.05.2018 filloi hetimi administrativ pranë kontrolluesit Shoqëria “HTT - High Tech Tests” sh.p.k. Tiranë, me objekt kontrolli:

- ✓ Zbatimi i Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit “HTT - High Tech Tests” sh.p.k. Tiranë, dhe verifikimin e ankesës nr. 814 prot., datë 04.05.2018.

Në funksion të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, “HTT - High Tech Tests” sh.p.k. Tiranë, është kontrollues i cili mbledh dhe përpunon të dhëna personale të kategorive “punonjës” dhe “vizitorë”. Kontrolluesi “HTT - High Tech Tests” sh.p.k. Tiranë, është regjistruar si person juridik tregtar në datë 15.02.2014 dhe Nipt: L41419011B.

Aktiviteti i tij tregtar konsiston si më poshtë:

Verifikimi i matësave të energjisë elektromekanike dhe statik të energjisë elektrike aktive dhe reaktive, verifikimi i matësve mekanik dhe elektronik të ujit të pijshëm, verifikimi i aparateve matës të gazit. Kalibrimin e të gjithë llojeve të matësve të energjisë elektrike, kalibrimin e instrumentave etalon standard të energjisë elektrike, kalibrimin e të gjithë instrumentave dhe aparateve matës që përdoren në fushën e sektorit të energjisë elektrike. Testimi i pajisjeve elektrike e instrumentit etalon. Ekspertizë në fushën e matjes së energjisë elektrike. Projektimi dhe instalimet elektrike të tensionit të ulët, mesëm dhe të lartë. Auditimi i instalimeve elektrike për abonentët familjarë, privatë dhe industrial etj, sipas ekstraktit të QKB-së.

Për sa i përket kontrollit administrativ në lidhje me pikën e parë të objektit të Urdhrit Nr.147 datë 18.05.2018 të Komisionerit, për zbatimin e ligjit, grupi i kontrollit pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga “HTT - High Tech Tests” sh.p.k. Tiranë, konstatoi si më poshtë:

1. Kontrolluesi nuk ka “Njoftuar” pranë Zyrës së Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale.  
Ky konstatim përbën shkelje të neneve 21 dhe 22 të ligjit, i cili shprehet:  
“1. Çdo kontrollues duhet të njoftojë komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë”.
2. Kontrolluesi nuk ka hartuar rregullore të mirëfilltë për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, por aktiviteti është i certifikuar sipas standardit ISO 27001/2013 për Sistemet e Menaxhimit të Informacionit. Kjo certifikatë është e vlefshme deri në vitin 2019.
3. Kontrolluesi ka nënshkruar “*Deklaratë Konfidencialiteti*” (modeli referencë sipas Standardit ISO 27001/2013 për Sistemet e Menaxhimit të Informacionit), me punëmarrësit të cilët kanë akses në përpunimin e të dhënave personale. Në kontratat individuale të punës neni 12, janë parashikuar klauzola për ruajtjen e sekretit mbi çdo informacion mbi të cilin është vënë në dijeni gjatë punës së tij.
4. Kontrolluesi disponon një sistem video-survejimi (CCTV) nëpërmjet të cilit mbikëqyr hyrjen e zyrave në të cilin ushtron aktivitetin, parkingun e pallatit, gjeneratorët, taracën, pompën e ujit, zyrat e punonjësve si dhe dhomën e serverave. Koha e ruajtjes së të dhënave imazhe video konstatohet të jetë 30 ditë.  
Kontrolluesi jep arsyet e ligjshme të pajisjeve në zyra me kamera survejuese, pasi siguria është e domosdoshme për informacionin konfidencial të kontrolluesit, financat, etj, si dhe në përputhje me kërkesat e ISO/27001:2013.
5. Kontrolluesi informon subjektet e të dhënave mbi prezencën e sistemit të video-survejimit (CCTV), nëpërmjet tabelave informuese të cilat nuk janë sipas modelit standard të miratuar me Udhëzimin nr. 3/2010 të Komisionerit “*Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit...*”.

Ky konstatim përbën shkelje të nenit 18 të ligjit dhe Udhëzimit nr. 3/2010 të Komisionerit “Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit...”.

6. Nga grupi i kontrollit u konstatua se, në kontratën me Shoqërinë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Sh.a., kompania “HTT – High Tech Tests” sh.p.k. në cilësinë e përpunuesit, nuk ka marrë masa të plota mbi zbatimin e konfidencialitetit, në përputhje me aktin nënligjor të Komisionerit, Udhëzimit Nr.19, datë 03.08.2012, mbi “Rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”.

Ky konstatim përbën shkelje administrative të neni 20 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, i cili shprehet:

“1. Kontrolluesit, për përpunimin e të dhënave personale, mund të punësojnë përpunues, të cilët garantojnë përdorimin e ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave. Çdo përpunues i të dhënave personale ka këto detyrime:

- a) të përpunojë të dhënat vetëm në përputhje me udhëzimet e kontrolluesit; të mos i transmetojë ato, përveç kur ka marrë udhëzim nga kontrolluesi;
- b) të marrë të gjitha masat e sigurisë, sipas këtij ligji dhe të punësojë operatorë, të cilët kanë detyrimin për ruajtjen e fshehtësisë;
- c) të krijojë, në marrëveshje me kontrolluesin, kushtet e nevojshme teknike dhe organizative për përmbushjen e detyrimeve të kontrolluesit, për të siguruar të drejtat e subjekteve të të dhënave personale;
- ç) t’i dorëzojë kontrolluesit, pas përfundimit të shërbimit të përpunimit, të gjitha rezultatet e përpunimit dhe dokumentacionit, që përmban të dhëna ose t’i mbajë apo t’i shkatërrojë ato me kërkesë të kontrolluesit;
- d) të vërë në dispozicion të kontrolluesit të gjithë informacionin e nevojshëm, për të kontrolluar përputhshmërinë me detyrimet, që rrjedhin sipas shkronjave të mësipërme.

2. Detyrimet e pikës 1 përcaktohen në kontratën e shkruar e kontrolluesit me përpunuesin”.

Në përfundim të procesit të hetimit administrativ, grupi i kontrollit hartoi proces verbalin, i cili u lexua në prani të palëve. Përfaqësuesi i kontrolluesit nuk paraqiti pretendime, por u shpreh se do të realizojë menjëherë detyrimet ligjore.

Faktet e mësipërme, (mos kryerja e detyrimit për të njoftuar përpunimin e të dhënave personale pranë komisionerit dhe mos hartimi i kontratave me të tretë, sipas formatit të Aneksit nr. 1 të Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit), përbëjnë shkelje të dispozitave të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Në datë 04.06.2018, pranë Zyrës së Komisionerit është depozituar Formulari i njoftimit nga ana e kontrolluesit “HTT – High Tech Tests” sh.p.k. (Pika 1 e procesverbalit është përmbushur).

Për sa i përket kontrollit administrativ në lidhje me pikën e dytë të objektit të Urdhrit Nr.147 datë 18.05.2018 të Komisionerit, mbi verifikimin e ankesës nr.814 prot., datë 04.05.2018 të ankuesit , grupi i kontrollit konstatoi:

Ankuesi pretendon:

*“Kompania “HTT - High Tech Tests” sh.p.k. Tiranë, ka përdorur emrin tim me persona të punësuar të tjerë. Me emrin tim dhe pa dijeninë time është punuar në qytetet Përmet, Sarandë, Vlorë etj”, ku rezulton se është mbajtur në mënyrë fiktive, “Raporti i verifikimit dhe/ose bashkëvulosjes të matësit elektrik në terren”.*

Grupi i kontrollit, vazhdoi hetimin administrativ, mbi verifikimin e ankesës nr.814 prot., datë 04.05.2018 dhe administroi provat e paraqitura nga ankuesi, që janë tre fashikuj të dosjes, mbi çështjen e hapur nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, dhe që ju kthyen ankuesit me kërkesën e tij.

Në zbatim të neneve 87 dhe 88 të Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, përpara marrjes së vendimit përfundimtar, në datë 25.06.2018 është organizuar seanca dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit lidhur me konstatimet e grupit të kontrollit mbi zbatimin e ligjit nga ana e kontrolluesit “HTT - High Tech Tests” sh.p.k. Tiranë, si dhe ballafaqimin e tij me palën ankuese , për sa i përket ankesës nr.814 prot. datë 04.05.2018.

Ankuesi gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore midis palëve, nuk paraqiti prova shkresore që të vërtetonin pretendimet e ngritura në ankesën e tij me nr.814 prot., datë 04.05.2018.

Zyra e Komisionerit, në zbatim të Ligjit Nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, pasi hetoi të gjitha faktet, vlerësoi të gjitha rrethanat për zgjidhjen e çështjes, çmon se, ankesa e subjektit të të dhënave nuk qëndron, pasi nuk jemi në kushtet e shkeljes së Ligjit Nr.9887/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Në seancën dëgjimore, përfaqësuesi i kontrolluesit u shpreh:

- Kemi përmbushur detyrimet ligjore sa i përket shkeljeve të konstatuara nga grupi i kontrollit.
- Dokumentacioni i paraqitur nga përfaqësuesi i kontrolluesit në datë 04.06.2018, që vërtetonte përmbushjen e konstatimeve të procesverbalit, mbajtur nga grupi i kontrollit, dhe nënshkruar nga palët, u administrua në cilësinë e provës shkresore.
- Lidhur me ankesën e , kontrolluesi pretendon se qytetari ka qenë punonjës por është shkarkuar për shkelje të disiplinës në punë.

Në lidhje me pretendimet e mësipërme të kontrolluesit, Zyra e Komisionerit shprehet:

Kontrolluesi pavarësisht se i ka përmbushur konstatimet e grupit të kontrollit gjatë hetimit administrativ, mbetet në shkelje të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar. Kontrolluesi ka pasur gjithë mundësinë për t’u njohur me ligjin dhe detyrimet që rrjedhin nga ky ligj, dhe aktet e tjera nënligjore, madje që me marrjen e njoftimit për zhvillimin e hetimit administrativ nga ana e Zyrës së Komisionerit, në datë 04.05.2018.

Shkeljet e konstatuara në zbatimin e Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, detyrimet që rrjedhin nga ky ligj dhe aktet e tjera nënligjore, konsistojnë në moszbatimin e parimeve bazë të mbrojtjes së të dhënave personale, dhe cenimin e sigurisë së të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë hetimit administrativ në kuptim të nenit 39.1 germa “ç” dhe “d” të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

*ç) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk zbatojnë detyrimet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë.*

*d) kontrolluesit që nuk përmbushin detyrimin për njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë.”.*

Kontrolluesi, “HTT - High Tech Tests” sh.p.k. Tiranë, në formën ligjore të aktivitetit të tij është person juridik dhe sipas nenit 39/2 për kundërvajtjet e mësipërme, dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se kontrolluesi ka rikuperuar shkeljet e konstatuara, ka qenë bashkëpunues me grupin e inspektimit gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, por shkeljet e konstatuara edhe pse të përmbushura (jashtë afateve ligjore), prej tij janë të ndëshkueshme pasi lidhen me sigurinë e të dhënave personale dhe parimet bazë të mbrojtjes së tyre.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Në zbatim të neneve 20, 21, 22, 31 germa “ë” dhe 39.1 germa “ç” dhe “d” të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar,

#### **V E N D O S A :**

1. Dënimin e kontrolluesit “HTT - High Tech Tests” sh.p.k. Tiranë, me gjobë në vlerën e **30 000 (tridhjetë mijë) lekëve**, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 20 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.
2. Dënimin e kontrolluesit “HTT - High Tech Tests” sh.p.k. Tiranë, me gjobë në vlerën e **20 000 (njëzetë mijë) lekëve**, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 21 dhe 22 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.
3. Rrëzimin e ankesës me nr.814 prot., datë 04.05.2018, të subjektit të të dhënave
4. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbartimit.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot, më 3. 1. 2018

**KOMISIONERI**  
**Besnik Dervishi**

*B*

*Besnik Dervishi*

